


BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
DREJTORIA GJELBËRIMI DEKORAT

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KLASA NR.1

- **Karrige me 1 krahë tavolinë**



Karrige me një krah tavolinë për klasën nr 1.


Karrigia dhe tavolina duhet të jenë rezistente ndaj peshave, goditjeve, gervishtjeve, qëndrueshmërisë dhe stabilitetit, njollave, dizinfektanteve etj.

Elementët përbërës të karriges mbështetja dhe ulësja do të jenë prej laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët e karriges janë metalike.

Tavolina me krah do të jetë me material dru lisi i cili i reziston më shumë kohës në jetëgjatësinë e saj. Aksesorët që përdoren për montimin e karriges së bashku me tavolinën me një krah të jenë cilësorë. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paketohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

- **Veshje e faqes së murit**


Veshje e faqes së murit me MDF(rimeso lisi), spesor 2cm . Në këtë faqe muri të veshur me Mdf (rimeso lisi) do të kemi disa sergjen të cilët do të vendosen mbi disa elementë druri cilindrik (\varnothing 2.5cm). Element tjetër plotësues i cili do të vendoset te veshja e murit me MDF lisi do të jetë dhe smartboard-i. Smartboard-i do të ketë dimensione 2m x 1.3m. Në realitetin e kohëve të sotme, objektet e shërbimit duhet të përshtaten me nevojat për ndryshim me fuqinë e tabelave dhe softuerit ndërveprues SMART Board Pro®. Nëpërmjet bashkëpunimit dixhital përmirëson rezultatet e trajnimit. Të gjitha me lehtësi të jashtëzakonshme




• Këndi statik i bicikletave

Është menduar që pranë dritareve që janë me pamje nga oborri i bicikletave të vendosen 4 poste pjesë-bicikletash me ulëse statike të cilat do të shoqërohen me një plan pune.

Me këto pjesë bicikletash statike do të bëhet e mundur pedalimi i tyre në vend. Plani i punës do të kapet në mur me prizhonier, me një gjerësi prej 26 cm dhe me gjatësi 460cm. Materiali laminat, ngjyra e verdhë. Plani do të ketë një lartësi prej 63 cm i përshtatshëm për fëmijë nga mosha 7 deri 11vjeç. Poshtë këtij plani do të kemi një raft metalik(ngjyra e verdhë). Po në këtë faqe do të kemi një dollap me rafte me dimensione 55 cmx 26 cm h=350 cm, materiali mdf .





Shëmbull ilustrues



• Dollap

Dollapi me rafte i cili do të jetë në funksion të materialeve ndihmëse për klasën nr.1 do të jetë me material mdf dhe me dimensione $55 \times 26 \times 350$ cm.

Pjesë e kësaj klase është dhe një hapësirë depo me sip prej 2.8 m^2 . Kjo depo do të ketë dy module raftesh me dimensione 121×45 cm secila. Materiali melamin 2cm .




KLASA NR.2

• Tavolina, karrige


Klasa nr 2 është menduar me tavolina dhe karrige të adaptueshme në mënyrën e vendosjes dhe organizimit në klasë. Ato mund të jenë në forëm rrethore duke bërë 3 module të tilla ose grupime të tjera.

Tavolinat do të jenë në forëm trekëndore me dimensione të brinjëve të tavolinës 76cm x 67cm, lartësi 64 cm. Materiali i suprinës laminat, me 3 këmbë cilindrike Ø 3cm materiali metalik.

Karrigia përfëmijë të moshës 7 deri 11 vjeç. Lartësia e karriges do të jetë 38 cm. Ulësja dhe mbështetësja e karriges do të jenë me material druri dhe struktura e saj metalike.



TAVOLINA 18 COPË




KARRIGE 18 COPË



• Veshje muri


Për pjesën e shpjegimit të mësimit njëra prej faqeve të hapësirës do të jetë e veshur me rimeso lisi 2 cm me lartësi 3 metra. Te kjo faqe me rimeso lisi do të kemi 3 serjen me dimensione 70 cm x 20 cm ku do të mbahen nga element druri cilindrik Ø 2.5 cm . Kjo faqe muri do të ketë dhe smartboard-in e saj me dimensione 200cm x130 cm e lart dhe smartboard-in e saj me dimensione 200cm x130 cm. Smart board-i do të ketë një lartësi nga dyshemeja prej 78 cm.

Rimesoja e lisit do të trajtohet në një pjesë të sipërfaqes së saj me të çara rrethore të cilat do të jenë të baraslanguara nga njëra- tjetra. Këto të çara rrethore përvèç dizanjit të tyre do të kenë dhe funksion mbajtës për 3 serjen.



- **Historiku i biçikletave (Element dekorativ informues)**


Detaji i pexiglasit



Pexiglesi do të jetë me dimensione 570cm x 150cm, material i printuar i historikut të biçikletave në dopio pexiglas. Pexiglesi do të kapet me vidator ku do të mbërthehen në mur.

- **Modul duralumini me xham (tek derë)-klasa nr 2**

Dera do të jetë me dimisione 100cm x 210 cm, hapsirat fiksë të xhamit janë 4 .Moduli i duraluminut me xham është 258cm x 300cm.




- **Mobilje raft**

Mobilje në funksion të klasës me dimensione 360cm x 30cm x 92cm. Materiali Mdf (rimeso lisi).

Kjo mobilje është menduar me dy rreshta në formën e kubave me dimensione 45 cm x 45 cm.

Funksioni I saj është për të mbajtur material didaktike për trajnimin si dhe mini - garderobë për fëmijë, mosha 7-11 vjeç.




KUZHINA

• Banko kuzhine

Kuzhina ndodhet pranë klasës nr.2 e cila do të jetë në funksion të administirates.

Ajo përbëhet nga një aparat uji, 1 fast vending machine dhe pjesa e mobiljes me gjatësi bango 186cm dhe gjerësi 50 cm, lartësi dysheme banak 90 cm. Pjesa e planit të bangos ka një hapësirë boshe poshtë saj ku mund të qëndrojnë 2 poste ulëse për të konsumuar ushqim. Si dhe një hapësirë me gjerësi 86 cm me dy kapakë mdf.



• Stola 2 copë

Stola në funksion të kuzhinës , ulëse PVC dhe strukturë metalike. Para se te filloje prodhimi ngjyrat dhe aksesoret do te percaktohen nga personi perjegjes i caktuar nga investitori.
Prodhim, Furnizim dhe Vendosje.




ZYRA NR 1

• Tavolinë

Tavolinë me mdf lisi, do të kemi dy poste vende pune ku tavolinat do të jenë me dimensione 60cm x 120 cm secila. Si dhe dy poste ndihmëse pune ,me plan pune me dimensione 120x 45 cm.

Lartësia e tavolinës është 75 cm.



• Karrige zyre


Karrige zyre me rrota 2 copë

Karrige zyre pa rrota (2 copë)



- **Tavolina nr 2**


2 poste vende pune karrige zyre. Tavolinat janë me dimensione 120 cm x 60cm, materiali mdf lisi.



Karrige zyre me rrota 2 copë

- **Dollap**


Te zyra nr 1 në faqen e murit do të kemi një dollap zyre e cila një pjesë e saj do të ketë rafte me kapak të mbyllur dhe një plan të hapur me lartësi nga dyshemeja 90cm. Kjo mobilje ka dimensione 460cm x 30cm x350cm. Deri në lartësinë 263cm kjo mobilje do të jetë funksionale, dimensioni tjetër i lartësisë që mbetet 87cm do të jetë pllak mdf lisi jo funksionale që tregon vazhdimësinë e mobiljes.



ZYRA NR 2

- Tavolinë

Te zyra nr 2 do të kemi 1 post pune ku do të ketë 1 tavolinë pune me dimensione 120cm x 65cm dhe me lartësi 75cm. Materiali mdf lisi me spesor 2cm. Kemi një karrige me rrata dhe një karrige pa rrata.



(1copë)

Karrige me rrata (1 copë)

Karrige pa rrata


- Karrige






- **Raft 350cm x 30cm x 110 cm**

Në funksion të zyrës nr 2 kemi 1 mobilje në funksion të dokumentacionit të zyrës. Kjo mobilje është me dimensione 350cm x 30cm x 110 cm. Kjo mobilje do të jetë e mbyllur me kapak në të gjithë gjatësinë e saj në lartësinë 110 cm. Materiali mdf lisi me spesor 2 cm.



ZONA E HOLLIT

- **Pupa**



Përbëhet nga 6 pupa me veshje me tapiceri dhe 2 tavolina metale të lyera me bojë të kuqe.


Pupat do të janë me dimensione të ndryshme:

1 pupë me diameter 140cm

2 pupa me diameter 75 cm

1 pupë me diameter 100cm

2 pupa me diameter 50 cm




- **Veshja e murit (te holli) me strukturë metalike zyra nr 1.**



Struktura metalike do të kornizojë muret perimetrale të jashtëm të zyrës nr1. Struktura metalike do jetë deri në lartësinë 3.5 metra. Profil metalik me dimisione 3x2 cm. Në drejtëkëndshin e formuar prej profileve metalike me dimisione 316 x350cm do të vendoset një biçikletë 29". Në gomat e kësaj biçiklete do të vendoset ndriçim led, biçikleta do të lyhet me ngjyrë të verdhë. Poshtë biçikletës do të shkruhet "SHKOLLA E BIČIKLETAVE" ngjyra e


zezë, materiali metalik dhe lartësia e shkrimit do të jetë 20 cm me gjatësi 215 cm.



Struktura metalike e gjitha do të mbulohet me rrjetë teli. Strukturë biçiklete e cila do të kapet te teli me upa metalike të vendosura në mur. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paketohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

- Veshje muri me adeziv / print letër murale**


Muri i hollit i cili është njëkohësisht dhe muri i klasës nr 1, do të vishet me letër murale në të gjithë perimetrin e saj.



• Garderobë

Garderoba do të jetë e vendosur në korridor me dimensione midis dy kollonave, e cila do të jetë me dimensione 460cm x 24cm x350 cm. Garderoba do të jetë me material mdf me lyerje (gri) dhe material mdf me rimeso lisi. Mobilja do të përbëhet nga 7 kanata të cilat do të jenë me dorezë të fshehur. Do të kemi element varje për rrobat e fëmijëve në një lartësi prej 146 cm nga toka dhe mbi këtë hapësirë do të kemi 10 hapësira për vendosjen e çantave. Pjesa 95 cm që mbyll mobiljen do të jetë kapak fallco.

Panjal-a




NYJE HIGJENO SANITARE

• Pasqyra

Pasqyra me dimensione 60 cm x 80 cm (sasia 10 copë)

Nyja e higjeno sanitare do të kemi 10 pasqyra me dimensione 60x80 cm me element metalik.



SERVISI I BIČIKLETAVE

- **Element për varjen e bičikletave në mur**


Në servisin e bičikletave do të kemi vendosjen e bičikletave në mur reth 26 copë:

-20 copë do të janë 1360cube ella 240

-6 copë 24"



Këto bičikleta do të vendosen në mur në lartësinë nga dyshemja 190cm.

Fjala BIČIKLETARIA dhe sinjalistika në mur do të printohen në forex 3 mm.




Bičikletat do të vendosen në mur me distancën në aks nga njera tjetra prej 36cm. Distanca nga dyshemeja te fundi i bičikletës në mur do të jetë 25.4 cm .Distanca nga fundi i bičikletës te bičikleta tjeter të cilat do të janë të shfazuara nga njëra tjetra është 20.32cm.

Bicikletat do të kapen në mur nëpërmjet një strukturë mbajtëse metalike e cila mbërthehet në mur me prizhioner. Gjatësia e kapëses metalike do të jetë 62 cm.




PAMJE ANËSORE E BICIKLETAVE




- **Tavolina e servisit & karrige**

Tavolina ka dimensione 400cm x 200cm x 75cm, materiali me rimeso druri. Spesori i syprinës do të jetë 4 cm. Tavolina do të ketë në total 24 sirtar, i cili do të jetë me dorezë të fshehur. Sirtarët do të shërbejnë për të mbajtur mjetet e punës. Tavolina do të ketë një konsol me gjatësi 75 cm ku përreth këtij konsoli do të vendose 5 stola. Mbi tavolinë do të kemi një element metalik dhe tako druri që do të shërbejnë për fiksimin e bicikletës mbi tavolinë.



Sasia 5 copë




• Parkimi i bicikletave në dyshemë

Në faqen e murit, në zonën e hyrjes në hapësirën e servisit është menduar fiksimi I bicikletave në një modul boxi me dimensione 843 cm x 302cm x 20cm. Materiali i këtij moduli do të jetë prej rimeso lisi.


Në këtë modul do të kemi disa të çara me gjerësi 5 cm për fiksimin e bicikletave. Në lartësinë 150 cm do të kemi një plan me dimensione 843cm x 24cm x 2cm për vendosjen e kokoreve të bicikletave si dhe për varjen e jelekëve me strukturë metalike poshtë këtij plani. Në këtë plan të murit do të vendosim dy imazhe me printim me adeziv.

PLANIMETRIA E MOBILIMIT SERVISI



KORRIDORI (DYSHEMEJA)


Zona e qarkullimit (korridori) –dyshemeja do të vishet me adeziv me një gjerësi rreth 120 cm e ndarë në dy korsi, ngjyra e verdhë. Ky shtrrim me adeziv do të përshkruajë dhe servisin e bicikletave në një pjesë të dyshemesë së saj.



VETRATAT



- **Veshje e dritareve të fasadës me adeziv**

VESHJE DRITARE ME ADEZIV



- **Tavolinë leximi me $d=60\text{cm}$ dhe $h=50\text{cm}$ (3 copë)**

Tavolinë e rrumbullakët për lexim. Baza është me tub çeliku me kolonë qëndrore $\varnothing 80\text{mm}$ deri në 100mm , pllakë dyshemeje $\varnothing 50$ deri në 65mm , bojë poliestër argjendi, e zezë mat. Skaji I sipërm 2.2cm trashësi. Përmasa e bazës së sipërme është me diametër 60cm .



Skaji I sipërm 2.2cm trashësi. Përmasa e bazës së sipërme është me diametër 60cm .



Karrige druri dhe pupa leximi

- **Karrige druri**

Lartësia e karriges do të jetë 40 cm.Ulësja dhe mbështetsja e karriges do të jenë me material druri dhe me këmbë druri .

Karrigia duhet të jenë rezistente ndaj peshave, goditjeve, gervishtjeve, qëndrueshmërisë dhe stabilitetit, njollave, dizinfektanteve etj.


Sasia (6 copë).

- **Pupa leximi**

Pupë leximi të lëvizshme me lartësi 35cm dhe diametër 50cm,60cm.


Pupë të brendshme/jashtë të papërshkueshme nga uji, poliestër, mbushje polisteroli.

Sasia (5 copë).



Raft librash (2 copë)

Raft librash me dimisone (210cm x 30cm x 280 cm),
Me strukturë metalike me 3 ndarje, me profil 3cm, me
veshje druri.




- **Zgarë metalike me vazo e varur në tavan (5 copë)**

Zgarë metalike me vazo e varur në tavan me dimensione 36cm x 150cm x 15cm, në të do të vendosen vazo me bimësi kacavjerrëse.



Zinxhirët metalik bëjnë të mundur kapjen e strukturës ne tavan me një zgjatim deri në 100 cm.

Struktura metalike është me profil 2cm, ku në të cilën është e inkorporuar vazo metalike në formë drejtkëndore e veshur me rrjetë metalike të lyer me bojë të zezë.




Vazo metalike me dimensione 120cm x 36cm x 90cm (3 copë)

Vazo metalike e dimensionuar ne plan
120




Vazo metalike me thellesi 25cm e veshur me rrjetë metalike, vazoja është e lidhur me strukturën mbajtëse metalike dhe funksionojnë si një element i vetëm. Në të do të mbillen bimësi të ndryshme.




Struktura metalike me profil 2cm, skeletit metalik ka te inkorporuar ne trup vazon metalike forme drejtkendore te veshur me rrjetë metalike. Lyer me bojë të zezë

Zgara metalike e dimensionuar



Zgara metalike pamja 3d



Struktura metalike me profil 2cm, skeletit metalik ka te inkorporuar ne trup vazon metalike forme drejtkendore te veshur me rrjetë metalike. Lyer me bojë të zezë.

Rrjetë metalike e lidhur tek struktura metalike

- **Ndriçues shinë industrial .**

Ndriçues shinë 2m të gjatë, ngjyrë e zezë.

Sasia e shinës (5 copë)

Sasia e spoteve (20 copë)



Shkronja 3D strukturë metalike me led 30 x 17cm(emërtimi i shkollës) fasada logo

Totali i shkronjave 64 copë,
bashkangjitur shëmbulli si në foto.

